



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.547/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.547/2023 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ të cilin me autorizim e përfaqëson _____ kundër Vendimit me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "*masë disiplinore-largim nga shërbimi civil*" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.547/2023 e datës 22.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anulohet** Vendimi me numër KD.nr.036/2022 i datës 22.02.2023 dhe Vendimi me numër KD-036/2022 i datës 20.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. **Mbetet në fuqi** Vendimi me numër KD.nr.036/2022 i datës 28.10.2022 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- IV. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës dhe të bëjë kompensimin e të gjitha pagave nga pezullimi i marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës që nga viti 2002, ndërsa sipas Vendimit me Nr.0008 të datë 06.01.2018 është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të Drejtoratit për Operativë, Siguri dhe Transportim të të Burgosurve në Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa sipas Akt Emërimit të datës 06.12.2017 ka qenë i caktuar në pozitën Udhëheqës për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, kurse sipas Vendimit me Nr.010512 të datës 20.09.2021 është bërë ndryshimi i Akt Emërimit të datës 06.12.2017 ku i është ndërruar pozita në Udhëheqës për Administratë, mirëpo me Vendimin me Nr. 01056 të datës 20.09.2021 është caktuar në vendin e punës *Udhëheqës për Administratë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë* në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Më datë 05.11.2016 sipas vendimit është formuar komisioni për hetimin e brendshëm për rastin e vdekjes së të paraburgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, i cili komision më datë 10.11.2016 ka përgatitur raportin përfundimtar me Nr. 1418.

Sipas shkresës të datës 05.08.2022 të Ministres së Ministrisë së Drejtësisë është obliguar Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë që të rishikoj të gjitha procedurat e brendshme të zyrtarëve në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe të gjithë zyrtarëve të tjerë të cilët kanë përpiluar raporte zyrtar ku në nëntor të vitit 2016 ku ka ndërruar jetë i paraburgosuri

Më datë 29.08.2022 Inspektoratit i Ministrisë së Drejtësisë ka nxjerr Raportin Zyrtar me Nr. 01-826 i cili i është dërguar Ministres së Ministrisë së Drejtësisë dhe Zëvendës Ministrit të Ministrisë së Drejtësisë. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë në bazë të raportit të cekur si më lartë dhe dhënë konstatimin sipas të gjeturave duke cituar se: *"Marrja dhe posedimi i incizimeve të kamerave të sigurisë me aprovim të ish Drejtorit të zyrtarët dhe komisioni i SHKK-së dhe janë marr në posedim para organeve kompetente të Policisë dhe Prokurorisë. Posedimi i të dhënave (incizimeve) paraqet shkelje ligjore sipas Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave neni 8 pika 1, neni 33 pika 1.5. Sipas Kodit Nr. 08/L-031 të Procedurës Penal, neni 89 nën paragrafi 1,3.25 dhe 1,315 dhe sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR.02/2012 për Fshehtësinë e Informacioneve, dhënien dhe Zbulimin e Tyre neni 3",* duke rekomanduar se këtu ka shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 pika 3 në paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 14.09.2022 ka paraqitur kërkesë me Nr. 925 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit më Komisionin Disiplinor, bazuar në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 21.09.2022 ka nxjerr vendim KD.nr.36/22 përmes të cilit ka bërë pezullimin e përkohshëm nga punë të ankuesit me 50% të pagës. Më datë 28.10.2022 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr Vendim KD.nr.036/2022 me të cilin ka bërë pezullimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se sipas informacioneve për të njëjtin zyrtar është hapur rasti në Prokurori sipas numrit të lëndës PPN-nr.273/22. Më datë 16.02.2023 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës i ka përcjell ankuesit ftesë për intervistë e caktuar më datë 20.02.2023 në orën 13:30 të cilën ftesë ankuesi e ka pranuar më datë 16.02.2023. Më tutje Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 20.02.2023 ka nxjerr Vendim KD-036/2022 më të cilin ka bërë shfuqizimin e vendimit të datës 28.10.2021 mbi pezullimin e procedurës disiplinore duke bërë

riaktivizmin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa më datë 22.02.2023 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr Vendim KD.nr.036/2022 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Ankuesi kundër Vendimit me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 22.03.2023 ka parashkruar ankesë me numër protokollin 2887/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 00.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendim me numër protokollin 4017/2023 të datës 03.05.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 2887/2023 të datës 22.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin Zyrtar të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë me Nr. 01-826 i datës 29.08.2022; Vendimin KD.nr.36/22 i datës 21.09.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin KD.nr.036/22 i datës 28.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesë për shkresat e nevojshme nga përfaqësuesit i ankuesit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshëm të SHKK-së e datës 10.03.2023; Autorizimin për përfaqësim; Vërtetim i datës 31.10.2022 nga Policia e Kosovës për ankuesin; Deklaratën me Nr. 1844/16 datës 09.11.2016 nga [] Deklaratë me Nr. 1843/16 e datës 09.11.2016 []; Deklaratën me Nr.1841/16 e datës 09.11.2016 nga []; Deklaratën me Nr.1843/16 të datës 09.11.2016 nga [] Urdhrin për Sekuestrim të Përkohshëm nga Prokuroria Themelore në Prishtinë PPN nr.329/16; Vërtetim për marrjen e përkohshëm të sendeve e datës 27.01.2017; Kërkesë për takim me Kryeprokurorin nga ankuesi për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës datë 31.01.2023; Vendimin KD.nr.036/2022 të datës 19.10.2023 të Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin KD-036/2022 i datës 20.02.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.1102/2022 i datës 01.02.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 06.04.2023; Akt Emërimit e datës 06.12.2027 për ankuesin; Vendimin me Nr. 01027 i datës 14.09.2021; Vendimin me Nr. 01056 i datës 20.09.2021; Vendimin me Nr. 01052 i datës 20.09.2021; Vendimin me Nr. 0008 i datës 06.01.2016; Kontratë punë për kohë të caktuar e datës 01.08.2014; Kontratë punësimit e datës 01.08.2011, 08.03.2010, 08.08.2008, 01.06.2008, 04.04.2008, 01.01.2008, 01.02.2006; Vendimin e datës 05.11.2016 për formimin e komisionit të hetimit; Raportin përfundimtar i hetimit në Qendrën e Paraburgimit

në Prizren me Nr. 1418 i datës 10.11.2016; Kërkesë me Nr. 925 i datës 14.09.2022 për inicimin e procedurë disiplinore ndaj ankuesit; Njoftimi PPN.nr.273/22 i datës 13.09.2022; Ftesë për intervistë e datës 16.02.2023 nga Komisioni Disiplinim për ankuesin; Vendimin me Nr. 1039 i datës 13.10.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 21.02.2023 dhe 20.02.2023; Emailin e datës 16.02.2023 nga për dhe Emailin e datës 20.02.2023 nga për.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se komisioni i tillë disiplinor nuk është dashur të shqyrtoj rastin për shkak se kryesues ishte në pozitë të drejtpërdrejtë si epror i pozitës aktuale të ankuesi, dhe njëjtë nga anëtarët e Komisionit Disiplinor z. ishte vartës i drejtpërdrejt i pozitës të cilën e ka pasur ankuesi; Komisioni Disiplinor duke qenë ende procedura disiplinore e pezulluar më datë 16.02.2023 ka aktivizuar procedurën disiplinore duke më ftuar në seancë të komisionit disiplinore ndërsa shfuqizimi i vendimit për pezullim të procedurës disiplinore është bërë më datë 20.02.2023; Komisioni Disiplinor ka shpallur përgjegjës ankuesit në kuptim të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërsa në atë kohë ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës edhe pse në fund të vendimit ky komision ka ngatërruar të dyja ligjet; Siç përmendet në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me kryerjen e veprës penale, Komisioni Disiplinor nuk është dashur të trajtojë këtë rast deri në përfundim të organeve të drejtësisë.

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës, konstaton se Komisioni Hetimor i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë më datë 29.08.2022 ka hartuar Raportin numër protokolli:01-826 me që rast janë dhënë konstatime sipas të gjeturave si në vijim: *"Marrja dhe posedimi i incizimeve të kamerave të sigurisë me aprovim të ish Drejtorit . tel zyrtarët dhe komisioni i SHKK-së dhe janë marr në posedim para organeve kompetente të Policisë dhe Prokurorisë. Posedimi i të dhënave (incizimeve) paraqet shkelje ligjore sipas Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave neni 8 pika 1, neni 33 pika 1.5. Sipas Kodit Nr. 08/L-031 të Procedurës Penal, neni 89 nën paragrafi 1,3.25 dhe 1,315 dhe sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR.02/2012 për Fshehtësinë e Informacioneve, dhënien dhe Zbulimin e Tyre neni 3", duke rekomanduar se këtu ka shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 pika 3 në paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10.*

Me ç' rast sipas provave të lëndës, si rezultat i këtij raporti është bërë edhe iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit, konkretisht Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datën 14.09.2022 ka paraqitur kërkesë me Nr.925 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor, ndërsa si përfundim i kësaj procedure disiplinore Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 22.02.2023 ka nxjerr Vendimin KD.nr.036/2022 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"* e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me arsyetimin se i njëjti ka shkelur dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të

Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sipas gjetjeve të Raportit Hetimor të datës 29.08.2022 të nxjerrë nga Komisioni Hetimor i themeluar në kuadër të Inspektoratit për Inspektimin e Punëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës në seancën e procedurës disiplinore të mbajtur me datë 20.02.2023, ka ftuar vetëm ankuesin ndërsa jo edhe iniciuesin e procedurës disiplinore dhe anëtarët e Komisionit Hetimor të cilit e kishin hartuar raportin e të datës 29.08.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nenit 12 paragrafi 4 dhe 5 lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore ka përcaktuar se: *“Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative”* pasi që në kuptim të nenit 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes. 95.1 Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar”,* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023, duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit”,* prandaj në rastin konkret Komisioni Disiplinor është dashur të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe të verifikojë dhe shqyrtojë çdo rrethanë juridike, fakt apo provë relevante dhe të dëgjojë variantin e palëve në procedurë për çështjen e ngritur.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me hartimin e Raportin Zyrtar me Nr. 01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nenin 188 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.3 ku përcaktohet se: *“1. Ministria mbikëqyrë zbatimin e dispozitave dhe të punës profesionale të punës së institucioneve Korrektuese dhe drejtorive rajonale sprovuese me qëllim të sigurimit të sistemit unik të ekzekutimit të sanksioneve penale, bartjen e përvojave, pozitive, analizimit dhe të përcjelljes së punës së disa njësive organizative të institucionit korrektues dhe të ofrimit të ndihmës profesionale atyre njësive; 2. Inspektori bënë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij Ligji, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe ka autorizim: 2.1. të hyj në çdo kohë dhe pa paralajmërim në të gjitha hapësirat dhe lokalet e Institucioneve Korrektues dhe drejtorive rajonale sprovuese me qëllim të inspektimit; 2.3. të verifikojë secilin rast veç e veç, çdo herë kur dyshohet për shkelje ligjore. Inspektori inicion procedurën qoftë sipas detyrës zyrtare, apo me iniciativën e personit të interesuar”* dhe ka ardhur në përfundimin se Inspektorët e Inspektoratit për Inspektimin e Punës së SHKK-së të cilët e kanë hartuar Raportin Zyrtar me Nr. 01-826 të datës 29.08.2022, kanë mandatin ligjor të kujdesen vetëm për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr.08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe akteve të tjera nënligjore që rrjedhin prej tij apo hyjnë në kuadër të fushëveprimit të punës në kuadër të SHKK, mirëpo tek rasti i ankuesit të njëjtit kanë dal jashtë mandatit dhe autorizimeve ligjore, ngase në faqen nëntë (9) të Raportit e datës 29.08.2022 kanë konstatuar se

ankuesi ka kryer shkelje të nenit 8 pika 1 dhe nenit 33 pika 1.5 të Ligjit 06/082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 89 nën paragrafi 1,3.25 dhe 1,3.15 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale pasi që i njëjti kanë marrë në posedim incizimin e kamerave të sigurisë papara organeve kompetente të Policisë dhe Prokurorisë, duke shtuar faktin se ankuesi ka shkelur edhe dispozitat e nenit 45 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 48 pika 5 i të njëjti ligj. Po ashtu në fund të Raportit Zyrtar me Nr. 01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë konstatimet e tij lidhur me shkeljet e rënda disiplinore nga ankuesi i kishte mbështetur në dokumentet zyrtare të Policisë së Kosovës ku dëshmohet edhe konfiskimin e USB-ve nga zyrtarët e lartcekur që dëshmon se ende nuk ka përfunduar rasti i hetimeve.

Nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit konstatimet e dhëna nga Komisioni Hetimor në Raportin e datës 28.09.2022 me numër:01-826 ku ishte konstatuar se ankuesi ka shkelur dispozitat e Ligjit 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, janë konstatime të cilat dalin përtej autorizimeve ligjore të Komisionit Hetimor në kuadër të Inspektoratit për Inspektimin e Punës së SHKK, pasi që lidhur me konstatimin e shkeljeve e dispozitave të Ligjit 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale autoriteti përgjegjës sipas këtij ligji është Agjencia për Informim dhe Privatësi, për konstatimin e shkeljeve të dispozitave Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale dhe shqiptimin e masës apo dënimit në klasifikimin e përcaktuar të shkeljes bëhet nga autoriteti gjyqësor-Gjykata Kompetente nën kushtet dhe procedurat e përcaktuara të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurë Penale, ndërsa për konstatimin e shkeljeve të dispozitave Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është Komisioni Disiplinor në kuadër të institucionit, kurse vendimet e Komisionit Disiplinor përmes procesit të ankimimit i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prandaj mbi këtë bazë ne mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"* konstatohet se Raporti i datës 28.09.2022 me numër:01-826 është akt administrativ i paligjshëm.

Po ashtu, ndërlidhur me veprimin e Komisionit Disiplinor i cili kishte mbajtur seancën e datës 20.02.2023 dhe kishte nxjerr aktin sipas të cilit ankuesi është shpallur përgjegjës duke mos ftuar palët në procedurë, duke mos shqyrtuar dhe analizuar në procedurë administrative asnjë konstatim të dhanë nga Komisioni Hetimor, janë veprime që bien ndesh me dispozitat e dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: *"1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"* ngase sipas detyrës zyrtare Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar të ftojë në seancë ankuesin, iniciuesin e procedurës disiplinore dhe të tre (3) anëtarët e Komisionit Hetimor të cilët e kishin hartuar Raportin e datës 29.08.2022 për të njohur me variantin e tyre të ngjarjes, mirëpo Komisioni Disiplinor ia ka falur besimin një raporti të nxjerrë nga Komisioni Hetimor i cili ka tejkalluar autorizimet ligjore, gjegjësisht të njëjtën kohë ka

ushtruar detyrat dhe kompetencat e tre (3) institucioneve të tjera të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 ka shkelur dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 10 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: *“Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative”* nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat e lartcekura ligjore të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në Raportin Zyrtar me Nr. 01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë i cili i referohet faktit se ankuesi ka bërë shkelje të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Kodit Nr. 08/L-031 të Procedurës Penale, atëherë Kolegji i Këshillit në bazë të provave të lëndës, konstaton se ky raport nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë është përcjellë tek Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, kjo konstatohet sipas Njoftimit PPN.nr.273/2022 të datës 13.09.2022 të Prokurorit të Shtetit i cili ka njoftuar Ministren e Ministrisë së Drejtësisë se: *“Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës më datën 12 shtator 2022, ju konfirmon pranimin e shkrësës tuaj drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me të cilën na keni informuar se Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë ka kryer inspektimin në lidhje me procedurat e brendshme të zyrtarëve të QP-Prizren dhe të gjithë zyrtarëve tjerë, me çka kanë përpiluar Raport zyrtar ku rezulton për shkelje të mundshme të personave përgjegjës në kuadër të autorizimeve që kanë patur. Meqenëse, ky rast është në kompetencën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Zyra jonë me qëllim të trajtimit të rastit Astrit Dehari, të gjithë dokumentacionin e pranuar nga Ju, e kemi përcjell Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale me kërkesë që i gjithë dokumentacioni i pranuar të shqyrtohet dhe të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore që ka”*.

Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë njoftim, vlerëson se rastin i ankuesit i cili potencohet edhe në Raportin Zyrtar me Nr. 01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, është në procedurë pranë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht në këtë kuptim Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk është dashur të ndërmerret veprimet për trajtimin e çështjes disiplinore ndaj ankuesit për faktin se nëse një çështje zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, atëherë çdo procedurë tjetër duhet të pezullohet sipas nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: “çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”,* nga rezulton faktin se kjo procedurë duhet të pezullohet siç është paraparë me Vendimin KD.nr.036/2022 të datës 28.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi KD-036/2022 i datës 20.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shfuqizimin e Vendimit të datës 28.10.2022 mbi pezullimin e procedurës disiplinore, dhe aktivizimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Sa i përket ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë, respektivisht Vendimit me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës,

Kolegji i Këshillit, konstaton se në dispozitiv të këtij vendimi konkretisht në pikën I ankuesi është shpall përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor në këtë rast ka shkelur ligjin material, ngase masën disiplinore ndaj ankuesit e ka shqiptuar mbi konstatimin se ankuesi me veprimet e tij ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.9 dhe 3.10 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa ky ligj nuk ka qenë në fuqi për kohën për të cilën është shpallur përgjegjës ankuesi, sepse Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje se Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik është i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 i cili ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020 dhe si rrjedhojë i njëjti ligj nuk ka efekt prapaveprues, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk mund ta gjejë përgjegjës ankuesin për shkeljen e dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për vitin 2016, gjegjësisht për kohën sa i njëjti ligj nuk ka qenë në fuqi.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.036/2022 të datës 22.02.2023 përmes të cilit akt, ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" është përcjellë me shkelje procedurale, gjegjësisht është përcjellë me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, prandaj si i tillë është akt i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe mbi këtë bazë Vendimi KD.nr.036/2022 i datës 22.02.2023 i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që një akt i tillë administrativ nuk ka mundur të përliqet për shkak të shkeljeve procedurale.

Mirëpo, nga se u tha si më lartë, meqenëse sipas Njoftimit PPN.nr.273/2022 të datës 13.09.2022 të Prokurorit të Shtetit, përmes të cilës konfirmohet se rasti është bartur në Prokurorinë Speciale për shkak të kompetencës, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk mund të zhvilloj asnjë procedurë tjetër, ndërsa pas shqyrtimit të rastit nga institucionet përgjegjëse, gjegjësisht Gjykatat kompetente dhe dhënies së verdiktit final, atëherë Komisioni Disiplinor mundet ta aktivizojë lëndën duke e liruar nga përgjegjësia apo duke i shqiptuar masën disiplinore ankuesit varësisht nga lloji i vendimit përfundimtar. Po ashtu, Kolegji Këshillit thekson faktin se mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nëse gjyqtari i çështjes vendos masë të pezullimit parandalues lidhur me ushtrimin e funksionit publik ndaj ankuesit, në këtë rast institucioni punëdhënës mund ta pezullojë nga puna ankuesin deri në zgjidhjen e çështjes kryesore.

Kështu që deri në përfundimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e tij e punës dhe të bëjë kompensimin e të gjitha pagave nga pezullimi i marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.547/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.